



Republika e Kosovës
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO		REPUBLIC OF KOSOVO	
DEYERIA E KOSOVËS-YLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO		GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL		MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT	
AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË		AGENCY FOR RURAL DEVELOPMENT	
ARIJENÇIONI PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIN E RREZITIA PULJOPIRREKËT			
AGENCIJA ZA RAZVOJ RURALNOG RAZVOJA			
Organiz. Org.	07/14	Pr. Prot.	4654
Org. Unit.		Pr. Prot. No.	
Nr. i Faqes	53	Data	30.09.2015
Drejktoria		Data	
No. pages.		Date.	
PRISHTINE/A			

PLANI OPERACIONAL I PUNËS 2015

AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË





Përmbajtja

Lista e tabelave	5
Lista e figurave	5
DIVIZIONI I ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME	6
Sektori i personelit	6
Sektori i Logjistikës	7
Sektori Juridik	8
DIVIZIONI I MIRATIMIT TË PROJEKTEVE TË ZHVILLIMIT RURAL	9
MASA 101	9
MASA 103	10
MASA 302	10
MASA – Ujitja e tokave bujqësore	10
MASA 303 Zbatimi i strategjive Zhvillimore lokale qasja Leader	11
Trajnimi i stafit të DMPZHR	13
DIVIZIONI I AUTORIZIMIT TË PAGESAVE	14
MASA 101	14
MASA 103	14
MASA 302	14
MASA - Skema për Ujitjen e tokave bujqësore	14
MASA 303 Zbatimi i strategjive Zhvillimore lokale qasja Leader	15
Niveli regjional	15
Niveli qendror	15
Pranimi i Kërkesave për Pagesë	15
Vlerësimi dhe regjistrimi i kërkesave në nivelin qendror	16
Autorizimi për kontrollin në terren	16
Kalkulimi i faturave	17
Autorizimi i Pagesave dhe përgatitja e Vendimeve për Pagesë	17
Përgatitja e Listave e fermerëve për Pagesë	17
Raportimi për pagesa	18
Trajnimi i stafit	18



DIVIZIONI I PAGESAVE DIREKTE	19
Pagesat Direkte – Grurë dhe Farë Gruri	20
Pagesat Direkte – Misër dhe Luledielli	21
Pagesat Direkte – Perime në fushë të hapur	21
Pagesat Direkte – Pemishte ekzistuese	21
Pagesat Direkte – Blegtori	22
Pagesat Direkte – Vreshta ekzistuese dhe Material fidanor	22
vijon vitin 2016	25
DIVIZIONI I KONTOLLIT NË TERREN	26
Kërkesa e Divizionit të Kontrollit për kapacitetet njerëzore dhe logjistike	26
Kontrolli në terren për Pagesa Direkte/ Sipërfaqe	27
Kontrolli në terren për Pagesa Direkte/ Blegtori dhe Bletari	27
Kontrolli në terren për Pagesa Direkte / Vreshtave	28
Kontrolli në terren për Pagesa Direkte/ Perime në fushë të hapur	28
Kontrolli në terren për Pagesa Direkte / Qumësht sipas cilësisë	28
Kontrolli në terren për Pagesa Direkte / Materialit fidanor dhe therrja e kafshëve	28
Kontrolli në terren për Pagesa Direkte / Shpezëtari	28
Kontrolli në terren për Projektet e Zhvillimit Rural	29
DIVIZIONI I IT & REGJISTRAVE	34
Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR)	37
Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS)	42
LPIS-Mobile	45
Softueri Grant Menaxhmenti	46
Softueri për Indikatorë	50



Akronimet (Shkurtesat)

AZHB – Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

AM - Autoriteti Menaxhues

BB – Banka Botërore

DAP – Departamenti i Administratës së Përgjithshme

LPIS – Sistemit të Integruar të Manaxhimit dhe Identifikimit të Parcelave

MF SIMFK – Ministria e Financave, Sistemi i Menaxhimit të Financave Kosovë

APK – Agjencia e Pyjeve të Kosovës

AUK – Agjencia e Ushqimit të Kosovës

U/A – Udhëzues Administrativ

PD – Pagesa Direkte

PZHR – Projektet e Zhvillimit Rural

DAPZHR – Divizioni i Autorizimit të Pagesave për Projektet e Zhvillimit Rural

eFR – Regjistri Elektronik e Fermerëve

NIF - Numri Identifikues i Fermës



Lista e tabelave

Tabela 1. Buxheti për të gjitha Masat e Projekteve të Zhvillimit Rural 2015

Tabela 2. Buxheti për të gjitha Masat e PD 2015

Lista e figurave

Figura 1. Plani i implementimit për PD dhe PZHR 2015

Figura 2. Lidhja e regjistrave të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) që do të funksionojë gjatë vitit 2015

Figura 3. Sistemi i komunikimit të AZHB-së

Figura 4. Procesi i regjistrimit të fermerit në eFR gjatë vitit 2015

Figura 5. Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR)

Figura 6. Pjesën e cila është e zhvilluar në Regjistrin Elektronik të Fermerëve (eFR) e cila do të përdoret për aplikim online për mbështetje direkte për kafshë

Figura 7. Lidhja e LPIS-it me Agjencinë Kadastrale të Kosovës përmes Geoportalit

Figura 8. Sistemin e Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS)

Figura 9. Skemë si funksion LPIS-it dhe LPIS-MOBILE

Figura 10. LPIS-Mobile i cili funksionon (offline) pa qasje në rrjet të internetit i cili përdoret nga inspektorët për kontrollë në terren

Figura 11. Softuerin për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë

Figura 12. Softuerin për menaxhimin e granteve

Figura 13. Softuerin për autorizimin e pagesave

Figura 14. Ueb faqja e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB

Figura 15. Softuerin për indikator i cili funksionon në tri gjuhë: shqip, anglisht dhe serbisht

Figura 16. Skemën e komunikimit të rrjetit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Ministrisë së Administratës Publike, si dhe komunikimi i data-bazave të AZHB-së që janë të hostuara në dhomat e serverve në Ministrinë e Administratës Publike

Figura 17. Plani i Implementimit për Divizionin e TI & Regjistrave



DIVIZIONI I ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Administrata e Përgjithshme në kuadër të kompetencave sipas përshkrimit të detyrave të punës do të zhvilloj aktivitetet e planifikuara për menaxhimin e buxhetit, personelit, logjistikës, çështjeve ligjore dhe arkivimit.

Sektori i personelit

- Planifikimi i stafit për nevojat e AZHB-së sipas kërkesave të divizioneve bazuar në rregulloren e brendshme të organizimit të AZHB-së.
Duke marrë parasysh rritjen e numrit të skemave të mbështetjes për PD dhe PZHR, si dhe rritjen e buxhetit për grante dhe subvencione, planifikohet të rritet numri i stafit të AZHB-së në Divizionin e PD për 6 punëtorë për kohë të caktuar, Divizionin e PZHR për 7 punëtorë në zyrat regjionale të AZHB, Divizionin e AP 7 punëtorë në zyrat regjionale të AZHB-së dhe në Divizionin e KT - 4 punëtorë për kontrollë në terren në zyrat regjionale (shkurt - mars 2015).
- Hartimi i planit të trajnimeve të stafit të AZHB-së sipas propozimeve të sektorëve përkatës.
Përmbledhja e kërkesave të Divizioneve për nevojat për trajnim dhe kujdesi për sigurimin e kushteve për organizimin e këtyre trajnimeve në bashkëpunim me divizionet përkatëse dhe sektorin e logjistikës (permanent gjatë vitit 2015).
- Hartimi i planit dhe mirëmbajtja e evidencave të shfrytëzimit të pushimit vjetor.
Në fillim të vitit 2015 do të hartohet plani i pushimeve vjetore për të punësuarit e AZHB-së nga të gjitha divizionet dhe plani i përgjithshëm nga DAP do të plotësohen të gjitha kërkesat për pushim dhe do të mirëmbahet evidenca e shfrytëzimit të pushimeve vjetore (permanent gjatë vitit 2015).
- Monitorimi i vijueshmërisë në punë dhe përgatitja e raporteve mujore të vijueshmërisë.
Do të mbahet evidenca ditore e vijueshmërisë së punëtorëve, si në qendër dhe në zyrat regjionale të AZHB-së. Me përfundimin e muajit do të përpilohet raporti i përgjithshëm mujor i vijueshmërisë. Do të bëhet kontrolli periodik i vijueshmërisë për të gjithë punëtorët duke përfshirë edhe punëtorët në zyrat regjionale (në baza mujore).
- Kalkulimi i orëve shtesë dhe punës jashtë orarit për stafin e AZHB-së (permanent gjatë vitit 2015).
- Zhvillimi i procedurave të rekrutimit dhe procedurave disiplinore (sipas nevojës).



- Mirëmbajtja e dosjeve të punësuarve në AZHB duke azhurnuar vazhdimin e kontratave për Shërbime të Veçanta, si dhe vendimet për ndryshime eventuale të vendeve të punës për të punësuarit e AZHB-së.

Sektori i Logjistikës

- Ofrimi i kushteve sa ma të mira të punës për stafin e AZHB (sigurimi i hapsirës optimale, inventar, pajisje të TI dhe material për zyrë).

Do të zhvillohen aktivitete për sigurimin e hapësirës optimale për të punësuarit në AZHB në qendër dhe në zyrat regjionale. Gjatë këtij viti do të punohet për sigurimin e hapësirës së mjaftuar për stafin e AZHB-së, mundësisht në objekt publik në sipërfaqe prej minimum 1,000 m² për qendër dhe nga 70 m² për zyrat regjionale (gjatë vitit 2015).

- Planifikimi i nevojave të AZHB-së për inventar, TI dhe material për zyrë.

Hartimi i planit të nevojave për inventar në përputhje me planifikimin e rritjes së numrit të stafit në AZHB për kohë të caktuar.

Hartimi i planit për furnizim me material për zyra për nevojat e AZHB-së (shkurt 2015).

Kërkesat për furnizim me material për zyra do të bëhet çdo tremujor të vitit 2015.

Në bashkëpunim me Divizionin e TI do të hartohet nevojat për furnizim me pajisje të TI.

- Monitorimi i automjeteve në shfrytëzim nga AZHB-së.

Me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve të planifikuara të AZHB-së e sidomos kontrollin në vendngjarje do të duhet angazhuar nga tri vetura në secilën zyrë regjionale për formimin e nga tri ekipeve për kontroll në terren. Momentalisht në shfrytëzim të AZHB-së janë 17 vetura prej tyre 2 në shfrytëzim nga qendra dhe 12 nga zyrat regjionale, kurse 3 prej tyre në autoservis, do të bëhet kërkesë edhe për 10 vetura për mbulimin e nevojave (shkurt 2015). Mbikëqyrja e shfrytëzimit të automjeteve dhe përgatitja e raporteve mujore dhe periodike për shpenzimet (në baza mujore dhe periodike të vitit 2015).

- Monitorimi i shpenzimeve të qerasë, mirëmbajtjes së objektit, sigurimin e objektit, komunalive, shpenzimeve të energjisë dhe furnizimeve të tjera për nevoja të AZHB-së në zyrën qendrore dhe zyrat regjionale, duke përgatitur kërkesat për egzekutimin e pagesave (në baza mujore gjatë vitit 2015).

- Arkivimi i të gjitha shkresave hyrese dhe dalëse të AZHB-së, procedimi i shkresave përmes postës,

- Sigurimi i hapsirës për arkivimin e dokumentacionit të AZHB-së në depon e MBPZHR-së.



Sektori Juridik

- Hartimi i planit legjislativ për vitin 2015 (dhjetor 2014),
- Pjesmarrje në hartimin e Udhëzimeve Administrative për vitin 2015 për Pagesa Direkte dhe për Projektet e Zhvillimit Rural (janar - shkurt 2015),
- Monitorimi i zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe procedurave të shkruara për vitin 2015 (pas përfundimit të miratimit),
- Hartimi i kontratave, vendimeve dhe shkresave tjera sipas nevojës së AZHB-së (permanent gjatë vitit 2015),
- Menaxhimi i procesit të ankimimit në të dy shkallët e ankesave dhe procedurave për ngritjen e procedurave hetimore dhe gjyqësore për nevojat e AZHB-së (permanent gjatë vitit 2015).

Divizioni i Administratës së Përgjithshme në kuadër të kompetencave sipas përshkrimit të detyrave të punës do të funksionalizoi sektorin e financave gjatë vitit 2015.

Ky sektor do të merr përgjegjësitë për hartimin e kërkesës buxhetore për rishikimin e buxhetit për vitin 2015 dhe përgatitjen e KASH-it për vitin 2016-2018 të AZHB-së, si dhe përgatitjen e stafit dhe procedurave për ekzekutimin e pagesave për vitin 2016.



DIVIZIONI I MIRATIMIT TË PROJEKTEVE TË ZHVILLIMIT RURAL

Bujqësia dhe Zhvillimi Rural janë një ndër sektorët kryesor të cilët kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Për këtë arsye mbështetja (përkrahja) për investimet në fermat/ekonomitë bujqësore është i një rëndësie vendimtare për të përmirësuar sektorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Kosovë për të arritur standarde më të larta të jetesës, përmirësimit të kualitetit të prodhimeve dhe përpunimeve të ndryshme bujqësore.

Objektivat e përgjithshme të PZHR

- Rritja e aftësisë konkurruese të bujqësisë kosovare dhe zëvendësimi i importit;
- Krijimi i vendeve të reja të punës dhe shtimi i punësimit në viset rurale;
- Përkrahja e fermerëve, në sektorët e përzgjedhur, me qëllim të përafrimit me rregullat, standardet, politikat dhe praktikën e BE-së;
- Përkrahja e zhvillimit ekonomik, social dhe territorial duke synuar rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, nëpërmjet zhvillimit të kapitalit fizik;
- Adresimi i sfidave të ndryshimit klimatik përmes shfrytëzimit të energjisë së ripërtitshme.

Gjatë vitit 2015, Divizioni i Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural do të bëjë zbatimin e PZHR duke përfshirë masat, nënmasat dhe sektorët e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që janë pjesë e PZHR 2015 e që janë:

MASA 101

1. MASA 101 - “Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore” duke përfshirë:

- Sektori i pemëve frutore (molla, dardha, kumbulla dhe vishnje),
- Sektori i pemëve të imta (dredhëza, mjedra, manaferra dhe boronica),
- Sektori i perime (serra) dhe perime në ambient të hapur (duke përfshirë patatet),
- Sektori i mishit (trashja e viçave dhe broiler),
- Sektori i qumështit (lopë qumështore, dele dhe dhi)



- Sektori i rrushit dhe
- Sektori i pulave vezëve.

MASA 103

2. MASA 103 – “Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe atyre të peshkatarisë” duke përfshirë:

- Sektori i përpunimit të qumështit,
- Sektori i përpunimit të mishit,
- Sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve dhe
- Sektori i prodhimit të verës.

MASA 302

3. MASA 302 – “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve” duke përfshirë nënmasat:

- 302.1 - Bletaria – prodhimi, përpunimi dhe marketingu i mjaltit;
- 302.2 - Grumbullimi dhe përpunimi i prodhimeve jodrusore të malit dhe marketingu i tyre;
- 302.3 - Përpunimi i prodhimeve bujqësore (të kultivuara) dhe marketingu i tyre;
- 302.4 - Zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre;
- 302.5 - Zhvillimi i turizmit rural dhe turizmit në fermë.

MASA – Ujitja e tokave bujqësore

4. MASA - Ujitja e tokave bujqësore

1. Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, gjegjësisht Divizioni për Miratim të Projekteve të Zhvillimit Rural gjatë vitit 2015 do të bëjë zbatimin e masave të lartpërmendura të Programit 2015.



MASA 303 Zbatimi i strategjive Zhvillimore lokale qasja Leader

5.Masa 303.2 „ Zbatimi i strategjive Zhvillimore lokale qasja Leader „ Aktiviteti i parë „ Funksionalizimi i GLV-ve të përzgjedhura 2015 dhe Rrzh

Realizueshmëria e Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural do të rrjedhë sipas aktiviteteve dhe planit të paraparë.

Nr.	Masa	Buxheti i paraparë	%
1	MASA 101 - Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	11,000, 000.00	56.15
2.	MASA 103 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	5,000, 000 .00	25.5
3.	MASA 302 - Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve	1,500, 000.00	7.66
4.	MASA - Ujitja e tokave bujqësore	2,000,000.00	10.21
5.	Masa 303.2 „ Zbatimi i strategjive Zhvillimore lokale qasja Leader „ Aktiviteti i parë „Funksionalizimi i GLV-ve të përzgjedhura 2015 dhe Rrzhr’’	90,480.00	0.48
Totali i buxhetit		19,590480.00	100

Tabela 1. Buxheti për të gjitha Masat e PZHR 2015

Aplikimi – Publikimi i thirrjes për aplikim është planifikuar prej datës 25.02.2015 dhe do të zgjasë deri me datën 10.04.2015 për të gjitha masat e PZHR të parapara sipas Programit për Zhvillim Rural për vitin 2015. Së bashku me procesin e thirrjes për aplikim do të bëhet edhe distribuimi i materialit informues (Udhëzuesit për aplikant për masën 101, 103, 302 dhe skema - Ujitja e tokave bujqësore, si dhe fletëpalosjet dhe posterat për informatat shtesë mbi kriteret e përkrahjes për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2015).



Aplikimi do të bëhet nëpër zyrat regjionale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan) dhe do të zgjasë 45 ditë deri me datën 10.04.2015, kur edhe do të përfundojë procesi i aplikimit për të gjitha masat për të cilat është publikuar thirrja për aplikim.

Gjatë procesit të aplikimit do të kontrollohet kompletimi i dokumentacioneve, dorëzimi i aplikacioneve dhe kontrolli i pranueshmërisë së aplikacioneve gjatë procesit bëhet regjistrimi i aplikacioneve në sistemin e menaxhimit të granteve dhe kur të përfundoj procesi i aplikimit të gjitha dosjet e aplikuesve do të dorëzohen në zyret qendrore të AZHB-së në Divizionin e Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural me këtë edhe përfundon procesi i aplikimit.

Kontrolli administrativ, kontrolli mbi kriteret e pranueshmërisë dhe vazhdimi i procesit të kriterëve të përzgjedhjes.

Vlerësimi dhe autorizimi për kontrollen në terren - Të gjitha aplikacionet që i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë do t'i nënshtrohen procesit të kriterëve të vlerësimit në bazë të kriterëve të përcaktuara të përpiluara nga Autoriteti Menagjues do të bëhet vlerësimi i projekteve dhe do të bëhet rangimi i tyre në mënyrë automatike në sistemin e menaxhimit të projekteve.

Autorizimi për kontrollen në terren - Pasi të kryhet procesi i kriterëve të vlerësimit do të bëhet autorizimi i përfituesve të mundshëm për kontrollen e parë për të verifikuar kriteret e pranueshmërisë edhe në fushë (terren) se a i plotëson kriteret fermeri për me qenë përfitues i mundshëm. Autorizohet lista e fermerëve përfitues të mundshëm dhe dosjet të dërgohen të Divizioni i Kontrollës të cilët e organizojnë kryerjen e këtij procesi.

Periudha e kryerjes së këtij aktiviteti – Ky aktivitet do të kryhet menjëherë pas përfundimit të aplikimit për Projektet e Zhvillimit Rural 2015 dhe do të filloj me datën 15 prill, sipas prioriteteve vegetative të sektorëve përkatës, si: Sektori i vreshtave, Sektori i perimeve duke përfshirë pataten, Sektori i qumështit, pulave vojse, mishë (viça dhe brojler). Skema nacionale “Ujitja e tokave bujqësore” do të vazhdojmë me kriteret e përzgjedhjes për sektorët tjerë për Masën 302.1, 302.2, 302.3, 302.4 dhe 302.5, pastaj Sektori i përpunimit të qumështit, mishit, pemë perime dhe prodhimi i verës dhe se fundi masa 303.2 Aktiviteti i parë „Funksionalizimi i GLV-ve të përzgjedhura 2015 dhe Rrzh”

Miratimi - refuzimi i PZHR 2015 – Pas përfundimit të kriterëve administrative, kriterëve të pranueshmërisë, kriterëve të vlerësimit dhe raportit të inspektorëve të kthyer nga terreni do të bëhet miratimi apo refuzimi i PZHR.



Nëse bëhet refuzimi përpilohet vendimi për refuzim dhe i dërgohet fermerit për njoftimin e tij me shpjegimin e arsyeve për refuzim.

Nëse bëhet miratimi, atëherë përgatitet letra miratuese (ku specifikohen kushtet e implementimit) shpenzimet e pranueshme dhe koha e implementimit të projektit.

Periudha e kryerjes së këtyre aktiviteteve – Miratimi do të bëhet në periudhën sipas planit operacional që do të jetë mesi i muajit prill, në mënyrë kontinuele deri në përfundim të procesit që parashihet të jetë fundi i gushtit, me çka përfundon edhe procesi i miratimit për të gjitha masat e parapara për përkrahje të PZHR 2015.

Nënshkrimi i kontratës dhe fillimi i investimit – Me nënshkrimin e kontratës në mes të AZHB-së dhe përfituesit të mundshëm do të përfundon procesi i përzgjedhjes së përfituesve të mundshëm dhe përcaktohet koha e zgjatjes së kryerjes së investimeve për përfituesit e Projekteve të Zhvillimit Rural 2015.

Trajnimi i stafit të DMPZHR

Do të bëhet trajnimi i zyrtarëve regjional për procesin e aplikimit për PZHR para publikimit të thirrjes për aplikim, në mënyrë që zyrtarët të njoftohen me procesin e aplikimit.

Trajnimi i zyrtarëve të DPZHR për Masën 302 “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve”, trajnim tre ditor mars 2015.

Vizitë studimore e aprovuar në Agjencinë e Pagesave në Gjermani – mbi procedurat e implementimit të Projekteve të Zhvillimit Rural sipas IPARD.

Bashkëpunim të ngushtë me projektin “Përkrahje e mëtejme për MBPZHR” për forcimin e strukturave administrative për programimin, zbatimin dhe monitorimin, financuar nga BE.

Të priturat

Do të bëhet realizimi i aktiviteteve dhe detyrave të cekura më lart, në mënyrë sa më të suksesshme sipas planit dhe programit të paraparë dhe të arrihen objektivat e përgjithshme dhe specifike, do të rritet kualiteti i prodhimit në ferma prodhuese, përmirësimi i prodhimit në fermat përpunuese dhe rritja e sipërfaqeve të ngritura me pemë, perime, serra dhe kultura tjera të përfituesit e PZHR – si, higjiena në ferma, infrastruktura përcjellëse dhe standardet tjera minimale kombëtare që ndikojnë të përmirësohen dhe arrihen objektivat e projekteve të mbështetura nga MBPZHR-AZHB. Po ashtu, që sa më shpejt t’i implementojmë rregullat apo standartet e BE-së sa i përket Projekteve të Zhvillimit Rural.



Të gjitha pikat e planifikuara të lartpërmendura do të realizohen me sukses dhe në afatet e parapara kohore, për ti arritur objektivat e parapara.

DIVIZIONI I AUTORIZIMIT TË PAGESAVE

Gjatë vitit 2015 nga Dizioni i Autorizimit të Pagesave do të bëhet autorizimi i pagesave të PZHR duke përfshirë masat, nënmasat dhe sektorët e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që janë pjesë e PZHR 2015 e që janë:

MASA 101

- 1. Masa 101 “Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore”** duke përfshirë: sektori i pemëve frutore (mollë, dardhë, kumbull dhe vishnje), sektori pemëve të imëta (dredhëz, mjedër dhe manaferrë), sektori perime (serra), perime në ambient të hapur (duke përfshirë patatet), sektori i mishit (trashja e viçave dhe broiler), sektori i qumështit (lopë qumështore, dele dhe dhi), sektori i rrushit dhe sektori i pulave vojse.

MASA 103

- 2. Masa 103 “Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe atyre të peshkatarisë”** sektori i përpunimit të qumështit, sektori i përpunimit të mishit, sektori i përpunimit të pemëve, i perimeve dhe sektori i prodhimit të verës.

MASA 302

- 3. Masa 302 “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale”** duke përfshirë nënmasat:

- Nënmasa 302.1 “Bletaria prodhimi /përpunimi dhe marketingu i mjaltit”.
- Nënmasa 302.2 “Përpunimi i barishteve bimore mjekuese frutave pyjore dhe këpurdhave të grumbulluara”.
- Nënmasa 302.3 “Përpunimi në fermë dhe marketingu i prodhimeve bujqësore në shkallë të ulët” (perimet, fruta, barishte, erëza, bimë mjekuese, kërpudha, si dhe qumështi i deleve dhe dhive).
- Nënmasa 302.4 - Zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre
- Nënmasa 302.5 - Zhvillimi i turizmit rural dhe turizmit në fermë.

MASA - Skema për Ujitjen e tokave bujqësore

- 4. Masa “Skema për Ujitjen e tokave bujqësore”**



Në këtë Masa janë përfshirë investimet që kanë të bëjnë me: rehabilitimi dhe vazhdimi i kanaleve dhe gypave të ujitjes, ndërtimi i rezerarve të ujit, penda e ujit, drenazhi/ kullim, pompa të ujit, rehabilitimi, etj.

MASA 303 Zbatimi i strategjive Zhvillimore lokale qasja Leader

5. Masa 303.2 „ Zbatimi i strategjive Zhvillimore lokale qasja Leader „ Aktiviteti i parë „, Funkcionalizimi i GLV-ve të përzgjedhura 2015 dhe Rrzh

Për autorizim të pagesave për Projekte të Zhvillimit Rural për çdo përfitues prej momentit të kërkesave deri te autorizimi për pagesë, duhet të kaloj nëpër disa hapa të njëpasnjëshëm. Procesi fillon me kërkesën për pagesë e deri te ekzekutimi i pagesës nga financat. Hapat më të rëndësishëm në procesin e kërkesës për pagesë janë:

Niveli regjional

- Pranimi i kërkesave për pagesë,
- Kontrollimi i kërkesave për pagesë dhe dokumentacioni përcjellës,
- Kontrollimi i gjitha faturave dhe pagesave të bëra,
- Regjistrimi i kërkesës dhe faturave në sistem për menaxhimin e granteve.

Niveli qendror

- Kontrollimi, pranimi dhe regjistrimi i të gjitha kërkesave që vijnë nga zyrat regjionale,
- Përgatitja e dosjeve dhe përgatitja e listave për kontrollë të dytë,
- Kalkulimi i faturave të dorëzuara për investimet e kryera,
- Autorizimi i pagesës në bazë të raportit dhe faturave,
- Përgatitja e vendimeve për pagesë, si dhe
- Përgatitja e listave të fermerëve për pagesë.

Pranimi i Kërkesave për Pagesë

Kërkesa për pagesë bëhet në zyrat regjionale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan) dhe do të zgjasë deri dy javë pas përfundimit të kontratave të miratuara deri në fund të vitit 2016 tek Masa 103.



Gjatë procesit të pranimit të kërkesave për pagesë do të kontrollohet kompletimi i dokumentacionit në bazë të kriterëve të parapara, si dhe pranimi i faturave për të gjitha investimet e kryera. Nëse kërkesa për pagesë dhe dokumentacioni përcjellës janë në rregullë, atëherë kërkesa për pagesë pranohet dhe regjistrohet në sistemin e menaxhimit të granteve, ndërsa ato që nuk janë të kompletuar i kthehen fermerit për përmirësim. Kërkesat për pagesë të rregullta të pranuar në zyrat regjionale grumbullohen dhe dorëzohen në zyrat qendrore të AZHB-së, Divizioni i Autorizimit të Pagesave të Projekteve të Zhvillimit Rural. Më këtë edhe përfundon procesi i kërkesës për pagesë.

Periudha e kryerjes së këtij aktiviteti - Ky aktivitet do të filloj me pranimin e kërkesave të para për pagesë për Projektet e Zhvillimit Rural për vitin 2015 dhe pritet të filloj në fund të korrikut dhe do të vazhdoj deri në pranimin e kërkesës së fundit për pagesë. Në bazë të planifikimeve nga Divizioni i Miratimit të Projekteve, kërkesat e para pritet të filloj me pemë të imëta, serra, qumësht, mish dhe do të vazhdoi me pemë, vreshta, si dhe Masën 302. Ndërsa, sa i përket sektorit të përpunimit të qumështit, mishit, pemë, perime dhe prodhimi i verës do të vazhdojnë edhe në vitin 2016. Si dhe masa 303.2

Vlerësimi dhe regjistrimi i kërkesave në nivelin qendror

Të gjitha kërkesat e pranuar në zyrat regjionale kontrollohen edhe njëherë nga zyrtarët për pranimin e kërkesave për pagesë në nivel qendror, ri-verifikohen dokumentet e kërkuara për plotësim të kriterëve të parapara për pagesë. Të gjitha kërkesat për pagesë të pranuar në pajtim me kushtet e përcaktuara në letrën e informimit dhe kontratën regjistrohen në librin e pranimit, ndërsa ato të pakompletuara kthehen në zyrat regjionale për përmirësim.

Periudha e kryerjes së këtij aktiviteti –Ky aktivitet do të filloj me pranimin e kërkesave të para për pagesë për Projektet e Zhvillimit Rural për vitin 2015 dhe pritet të filloj në fillim të muajit gusht dhe do të vazhdoj deri në pranimin e kërkesës së fundit për pagesë.

Autorizimi për kontrollin në terren

Pasi të kryhet procedura e pranimit të kërkesave të gjitha kërkesat e pranuar së bashku me dokumentacionin nga miratimi i projektit, kompletohet lënda dhe autorizohet lista për Divizionin e Kontrollit për kontrollin e dytë në terren. Qëllimi i kontrollës në terren është verifikimi i të gjitha investimeve të cilat janë paraqitur me fatura dhe pagesat që janë kryer në terren, për të vërtetuar se a janë komfor projektit, letrës së informimit dhe kontratës. Pas përfundimit të kontrollës, së bashku me raport nga tereni kthehen përsëri në Zyrën për Autorizim të Pagesës.



Periudha e kryerjes së këtij aktiviteti – Ky aktivitet do të filloj me pas pranimin e kërkesave të para në nivelin qendror për pagesë për PZHR 2015 dhe pritet të filloj në fillim të muajit gusht dhe do të vazhdoj deri në pranimin e kërkesës së fundit për pagesë.

Kalkulimi i faturave

Pas përfundimit të kontrollës në terren, të gjitha kërkesat për pagesë i nënshtrohen procedurave të kalkulimit të faturave të pranuar për investimet e kryera. Në bazë të përshkrimit dhe fotografive të bëra nga inspektorët në terren, raporti nga terreni është një pasqyrë që shihet se si fermeri ka kryer investimet. Në këtë rast, faturat e dorëzuara do të krahasohen se a janë komfor investimeve të kryera në terren. Po ashtu, bëhet krahasimi i çmimeve të cilat janë paraqitur në fatura dhe a janë çmime të pranishme sipas çmimoreve të AZHB-së, dhe në bazë të kësaj bëhet autorizimi i pagesës për secilin përfitues.

Periudha e kryerjes së këtij aktiviteti – Ky aktivitet do të filloj me pas kryerjes së kontrollës në terren dhe pritet të filloj në mes të muajit gusht, dhe do të vazhdoj dy javë pas pranimit të kërkesës së fundit për pagesë.

Autorizimi i Pagesave dhe përgatitja e Vendimeve për Pagesë

Pas përfundimit të procesit të kalkulimit vazhdohet me autorizimit e pagesave për çdo fermer. Vlerën të cilën do ta përfitoj fermeri varet nga raporti nga terreni, faturat dhe pagesat e rregullta, planifikimet në projekt, si dhe vlera në kontratë. Në momentin e përfundimit të autorizimit të vlerës për pagesë përgatiten vendimet për ekzekutim të pagesës. Për çdo pagesë përgatitet Vendimi për Pagesë (një për AZHB dhe një për fermerin) nënshkruhen dhe vulosen.

Periudha e kryerjes së këtij aktiviteti – Ky aktivitet do të filloj me pas pranimin e kërkesave të para në nivelin qendror për pagesë për PZHR 2015 dhe pritet të filloj në mes të muajit gusht dhe do të vazhdoj dy javë pas pranimit të kërkesës së fundit për pagesë.

Përgatitja e Listave e fermerëve për Pagesë

Për të gjithë fermerët përfitues të projekteve të zhvillimit rural përgatiten listat për pagesë sipas masave dhe dërgohen në Divizionin e Financave në MBPZHR për ekzekutim të pagesës. Se bashku me listën për pagesë, në Divizionin e Financave dërgohen komplet dokumentacioni i nevojshëm për ekzekutim të pagesave.

Periudha e kryerjes së këtij aktiviteti – Ky aktivitet do të filloj me pas pranimin e kërkesave të para në nivelin qendror për pagesë për PZHR 2015 dhe pritet të filloj në mes të muajit gusht dhe do të vazhdoj tri javë pas pranimit të kërkesës së fundit për pagesë.



Raportimi për pagesa

Si detyrë e rregullt e vendit të punës është edhe përgatitja e raporteve të rregullta të punës. Për të gjitha aktivitetet e kryera nga ky Divizion përgatiten raporte javore, mujore, tremujore dhe vjetore. Përveç raportimit të rregullt, përgatiten edhe raporte tjera varësisht prej nevojave. Në këto raporte zakonisht ofrohen të dhëna për fermerët dhe kompanitë e paguara të PZHR, ndarjen e përfituesve për masa, nënmasa dhe ndarja e raporteve në bazë të buxheteve nga i cili realizohet pagesa.

Periudha e kryerjes së këtij aktiviteti – Ky aktivitet do të filloj me pas pranimin e kërkesave të para në nivelin qendror për pagesë për PZHR 2015 dhe pritet të filloj në fund të muajit korrik dhe vazhdon gjatë tërë vitit.

Trajnimi i stafit

Do të bëhet trajnimi i zyrtarëve regjional për procesin e pranimit të kërkesave për Pagesë për PZHR para fillimit të pranimit të kërkesave në mënyrë që zyrtarët të njoftohen me procedurat e kërkesës për pagesë. Po ashtu, të gjithë zyrtarët janë të gatshëm të marrin pjesë në trajnime, vizita të cilat do të ndikojnë në përmasimin e cilësisë së punë.



DIVIZIONI I PAGESAVE DIREKTE

Divizioni për Pagesa Direkte ka planifikuar implementimin e programit për Pagesa Direkte 2015. Planifikimi i implementimit të programit do të bëhet sipas Programit për Pagesa Direkte 2015.

Buxheti i planifikuar dhe masat për Pagesa Direkte 2015 është sipas tabelës në vijim:

Nr.	Sektorët që do të mbështeten përmes pagesave direkte	Buxheti (€)
1	Pagesa direkte për mbjelljen vjeshtore të grurit	6,600,000.00
2	Pagesa direkte për mbjelljen e farës së grurit	100,000.00
3	Pagesa direkte për mbjelljen pranverore të misrit	1,800,000.00
4	Pagesa direkte për mbjelljen pranverore të lulediellit	600,000.00
5	Pagesa direkte për vreshta ekzistues	2,500,000.00
6	Pagesa direkte për prodhimtarinë e materialit fidanor të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit mbi nënshartesat vegjetative	100,000.00
7	Pagesa direkte për lopë dhe buallica qumështore	3,080,000.00
8	Pagesa direkte për delet	1,658,000.00
9	Pagesa direkte për dhitë	150,000.00
10	Pagesa direkte për bletari	775,000.00
11	Pagesa direkte për qumështin sipas kategorive të cilësisë	1,500,000.00
12	Pagesa direkte për pulat vojse	237,000.00
13	Pagesa direkte për dosa në riprodhim (Derrari)	50,000.00
14	Pagesa direkte për perimet në fushë të hapur	2,000,000.00
15	Pagesat direkte për pemishtet ekzistues	1,100,000.00
16	Pagesat direkte për therjet e raportuara të gjedhit	750,000.00
Total buxheti për vitin 2015		23,000,000.00

Tabela 2. Buxheti për të gjitha Masat e PD 2015



Implementimi i Programit për Pagesa Direkte është planifikuar të bëhet përmes dy thirrjeve për aplikim, një thirrje për aplikim për Pagesa Direkte për sipërfaqe (grurë, fare gruri, misër, luledielli, perime në fushë të hapur dhe pemishte ekzistuese) dhe një thirrje për aplikim për Pagesa Direkte për blegtori (lopë qumështore, buallica, dele dhe dhi, pula vojse, dosa, qumësht sipas cilësisë dhe therrjet e kafshëve). Pjesë e këtyre dy thirrjeve do të jenë edhe Pagesat Direkte për Vreshta ekzistuese dhe Material fidanor.

Pagesat Direkte – Grurë dhe Farë Gruri

Bazuar në aplikimet e viteve paraprake për Pagesa Direkte - Grurë dhe Fare Gruri ne presim rreth 12,000 aplikacione me sipërfaqe totale prej përafërsisht 50,000 ha.

Paralelisht me procesin e aplikimit, ne kemi planifikuar që të bëjmë edhe kontrollin administrativ të aplikacioneve në Divizionin e Pagesave Direkte në mënyrë që të mos kemi vonesa për kontroll në terren.

Sa i përket Pagesa Direkte për sipërfaqe ne kemi planifikuar t'i japim prioritet kontrollit administrativ të aplikacioneve për Pagesa Direkte Grurë dhe Farë gruri pasi që numri më i madh i aplikuarve është në këtë Masë. Kontrolli administrativ i aplikacioneve për PD- Grurë dhe Farë Gruri ka filluar nga data 16.03.2015 dhe planifikohet të kryhet në javën e fundit të muajit Maj.

Do të kontrollohen administrativisht në masën 100 % të gjitha aplikacionet dhe do të vlerësohen se a janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë sipas thirrjes për aplikim.

Aplikacionet do të jenë të gatshme për kontroll në terren nga data 30.03.2015. Paralelisht me kontrollin administrativ do të përgatiten edhe aplikacionet për kontroll në terren.

Bazuar në kapacitetet ekzistuese - resurset njerëzore dhe logjistike, kontrolli në terren nuk do të mund të bëhet për më tepër se 50 % të fermerëve aplikues.

Përzgjedhja e mostrës për kontroll në terren do të bëhet sipas U/A për Pagesa Direkte për vitin 2015.

Pas përfundimit të kontrollit administrativ dhe kontrollit në terren do të filloi kalkulimi i pagesave për fermerët përfitues.

Të gjithë fermerëve do t'iu përgatitet vendimi për pagesë ose refuzim, varësisht prej rezultateve të kontrollit në terren. Vendimet do t'iu shpërndahen fermerëve gjatë muajit Korrik.

Planifikohet që pagesa për të gjithë fermerët përfitues të realizohet gjatë muajit Korrik 2015.

Buxheti i planifikuar për këto dy masa është 6,700,000.00 € dhe do të jetë buxhet i mjaftueshëm për përkrahje të fermerëve përfitues.



Pagesat Direkte – Misër dhe Luledielli

Meqenëse këtë vit kemi rritje të shumës së pagesave për hektar për 50 % tek Misri dhe Luledielli, ne presim që të kemi rritje të numrit të aplikuesve për këto dy kategori.

Kontrolli administrativ i aplikacioneve për Pagesa Direkte - Misër dhe Luledielli do të bëhet gjatë muajit maj dhe qershor.

Edhe në këtë Masë, kontrolli administrativ do të jetë 100 %.

Përgatitja e aplikacioneve për kontroll në terren është planifikuar të bëhet në muajin Qershor dhe Korrik.

Kalkulimi i pagesave, përgatitja e vendimeve për miratim dhe refuzim do të bëhet gjatë muajit Nëntor.

Buxheti i planifikuar për këto dy masa është 2,400,000.00 euro dhe sipas kalkulimeve tona do të jetë buxhet i mjaftueshëm për përkrahjen e të gjithë fermerëve përfitues.

Pagesat Direkte – Perime në fushë të hapur

Në kuadër të Pagesave Direkte - Perime në fushë të hapur është planifikuar që të subvencionohen 23 kultura bujqësore (bizele, spec, domate, patate, pjepër, shalqinj, kungull, kungull gjellë, kungull misri, fasule, qepë, patogjen i zi, rrepka, karota, hudhër, lakër, lulëlakër, majdanoz, panxhara, spinaq, tranguj, presh dhe marule).

Fermerët aplikues duhet të kenë të mbjellur minimum 0.50 ha me perime në fushë të hapur. Presim rreth 5,000 aplikacione në këtë Masë.

Kontrolli administrativ i aplikacioneve për Pagesa Direkte - Perime në fushë të hapur do të bëhet gjatë muajit maj dhe qershor në masën 100 %.

Përgatitja e aplikacioneve për kontroll në terren është planifikuar të bëhet në fillim të muajit korrik.

Kalkulimi i pagesave, përgatitja e vendimeve për miratim dhe refuzim do të bëhet gjatë muajit shtator.

Pagesat Direkte – Pemishte ekzistuese

Pagesat Direkte - Pemishte ekzistuese (pemë drufrutore dhe pemë të imta) do të implementohet për herë të parë. Do të subvencionohen pemët drufrutore: molla, dardha, kumbulla, ftoi, kajsi, pjeshkë, qershi, vishnje, mashmullë, si dhe pemët e imta: dredhëz, boronicë, mjedër dhe manaferrë. Presim që të kemi rreth 2,000 aplikacione në kuadër të kësaj Mase. Të gjitha sipërfaqet e mbjella me pemishte do të digjitalizohen përmes sistemit Lpis.



Kontrolli administrativ i aplikacioneve për Pagesa Direkte - Pemishte ekzistuese do të bëhet gjatë muajit prill dhe maj në masën 100 %.

Kontrolli në terren është planifikuar të bëhet gjatë muajit maj, qershor dhe korrik.

Fermerët që kanë aplikuar edhe për pemishte ekzistuese edhe për ndonjë kulturë tjetër bujqësore, si p.sh. grurë do të kontrollohen në terren përnjëherë me kulturat tjera.

Kalkulimi i pagesave, përgatitja e vendimeve për miratim dhe refuzim do të bëhet gjatë muajit shtator.

Pagesat Direkte – Blegtori

Programi i Pagesave Direkte për vitin 2015 ka paraparë subvencionimin e fermerëve që merren me Blegtori. Do të subvencionohen fermerët që mbarështojnë lopë qumështore, buallica qumështore, dele dhe dhi qumështore, dosa, blete, pula vojse, qumësht sipas cilësisë dhe therrjet e kafshëve.

Thirrja për aplikim për Pagesa Direkte - Blegtori është publikuar me datë 22.04.2015 dhe do të jetë e hapur deri me datë 05.06.2015. Këtë vit aplikimi për të gjitha kategoritë e kafshëve do të jetë në mënyrë online përmes programit - softëar-it.

Në kuadër të Pagesave Direkte - Blegtori presim që të kemi rreth 10,000 aplikacione.

Kontrolli administrativ i aplikacioneve do të bëhet në masën 100 %. Do të kontrollohen në terren min. 50 % e aplikuesve sipas përzgjedhjes së mostrës dhe vlerësimit të rrezikut.

Kontrolli administrativ i aplikacioneve për Pagesa Direkte - Blegtori është planifikuar të bëhet nga gjysma e muajit korrik deri në fund të muajit gusht.

Aplikacionet do të jenë të gatshme për kontroll në terren në muajin shtator.

Kontrolli në terren është planifikuar të bëhet në muajin shtator dhe tetor.

Kalkulimi i pagesave, përgatitja e vendimeve për miratim dhe refuzim do të bëhet gjatë muajit nëntor.

Sa i përket Pagesave Direkte - Qumësht sipas cilësisë dhe therjeve të kafshëve, thirrjet për aplikim do të bëhen sipas tremujoreve kalendarik të vitit. Gjithashtu, edhe kontrolli administrativ dhe pagesat do të bëhen çdo tremuj.

Pagesat Direkte – Vreshta ekzistuese dhe Material fidanor

Thirrja për aplikim për Pagesat Direkte - Vreshtat ekzistuese dhe Material fidanor të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit mbi nënshartesat vegetative është publikuar me datë 22.04.2015 dhe do të zgjasë deri me datë 05.06.2015. Meqenëse këtë vit për herë të parë është planifikuar digjitalizimi i parcelave me vreshta, atëherë shtyrja e afatit të aplikimit do të jetë i domosdoshëm.



Kontrolli administrativ i aplikacioneve është planifikuar të bëhet në muajin shtator, ndërsa kontrolli në terren do të bëhet gjatë muajit tetor. Do të kontrollohen një numër i vogël i aplikacioneve, për shkak se databaza e vreshtave konsiderohet si e saktë dhe e mirëmbajtur. Presim rreth 3,000 aplikacione për Pagesa Direkte – Vreshta, ndërsa për Pagesa Direkte - Material fidanor numri i aplikuesve është i vogël - rreth 20 aplikacione.

Kalkulimi i pagesave, përgatitja e vendimeve për miratim dhe refuzim do të bëhet gjatë pjesës së dytë të muajit tetor dhe në fillim të muajit nëntor.

Implementimi i Programit do të bëhet sipas Programit për Pagesa Direkte dhe Udhëzimit Administrativ për Pagesa Direkte për vitin 2015.

Përzgjedhja e mostrës për kontroll në terren do të bëhet sipas Udhëzimit Administrativ për Pagesa Direkte për vitin 2015, varësisht sipas përqindjes së kontrollit që kërkon ky udhëzim.

Për të gjithë Programin e Pagesave Direkte për vitin 2015 presim që të kemi rreth 40,000 aplikacione.



DIVIZIONI I KONTOLLIT NË TERREN

Plani operacional i kontrollit për vitin 2015 është hartuar pas konsultave dhe harmonizimit të aktiviteteve të planifikuara me Divizionet tjera të AZHB-së.

Në këtë plan do të prezantohet kontrollin e paraparë, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe aktet tjera, në zbatimin e Programit për Pagesa Direkte dhe Projektet e Zhvillimit Rurale 2015.

Kërkesa e Divizionit të Kontrollit për kapacitetet njerëzore dhe logjistike

Divizioni i Kontrollit të AZHB-së pas analizave të bëra me qëllim të mobilizimit stafit në qendër dhe inspektoratit, tani kur jemi në prag të fillimit të zbatimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2015 dhe Programit për Subvencione nëpërmjet të Pagesave Direkte është duke u ballafaquar me vështërsit, si:

- Vonesat në miratimin e programeve dhe shpalljeve publike për aplikim,
- Shtimi i masave dhe nën masave të reja,
- Supozimi se do të jetë numri i madh i aplikantëve,
- Numri i madh i kontrolleve në terren,
- Numri i vogël i stafit në raport me volumin e punëve,
- Mungesat e theksuara në pajisje dhe mjete tjera logjistike.

Duke u bazuar në vështirësit dhe mungesat e lartcekura, Divizioni i Kontrollit për realizimin cilësor të përgjegjësive të veta në zbatimin e Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2015 dhe Programit për Subvencione nëpërmjet të Pagesave Direkte, ka nevojë:

- të angazhuar staf shtesë, me periudhë të përkohshme, për kontroll në terren, së paku 10 (dhjetë) punëtorë,
- të sigurohen edhe 7 (shtatë) automjete për kontroll në terren,
- të sigurohen pajisje të TI-së (kompjuter, printer dhe aparat për fotokopje) pasi që 10 inspektorë nuk kanë kompjuter.
- Të sigurohet inventar për zyra, pasi që kemi mungesa gati në të gjitha zyret regjionale.



Kontrolli në terren për Pagesa Direkte/ Sipërfaqe

Kontrolli i Grurit - për sektorin e drithërave kontrolli në terren i lëndëve do të filloj me kontrollin e grurit nga java e fundit e muajit maj (25 maj) sipas planifikimit me planin për realizimin e Programit 2015, por duhet cekur se kontrolli realisht do të filloj nga pjesa e dytë e muajit mars, pasi që Divizioni i Pagesave Direkte pas javës së parë të aplikimit do t'i marrë lëndët nga zyrtarët komunal të bujqësisë dhe pas kontrollit administrativ do t'i sjellë lëndët tek Divizioni i Kontrollit për kontroll në terren. Pra, prioritet do t'i jepet si zakonisht kontrollit të grurit, pasi që është kulturë vjeshtore dhe ka numër më të madh të aplikuesve.

Kontrolli për Farë gruri - kontrolli i sipërfaqeve për farë gruri kryhet nga inspektorët fito-sanitarë të AUVK-it.

Kontrolli i Misërti - kontrolli në terren i sipërfaqeve të mbjella me misër do të filloj siç është prezantuar në plan, përkatësisht procesi i kontrollit të misrit do të filloj nga 25 maj - 20 korrik.

Kontrolli i Lulediellit - duke u bazuar në përvojat e vitit të mëhershëm, numri i aplikantëve për këtë kulturë vajore është i vogël dhe procesi i kontrollit do të lihet në fund të kontrollit për sipërfaqe, përkatësisht nga 13 - 20 korrik.

Procesi i kontrollit për aplikuesit për grurë, misër dhe luledielli planifikohet të jetë i përfunduar deri me 20 korrik 2015. Ky proces do të jetë më i lehtë dhe brenda afateve kohore nëse do të kemi mbështetje në burime njerëzore dhe mjete logjistike, sipas kërkesës së dorëzuar nga Divizioni i Kontrollit, për formimin e 18 ekipeve për kontroll dhe nëse miratohet ulja në përqindja e kontrollit, sipas orientimeve aktuale që të bëhet kontrolli 20 - 30% e aplikantëve varësisht nën masave.

Kontrolli në terren për Pagesa Direkte/ Blegtori dhe Bletari

Kontrolli për Lopë, Dele, Dhi, Buallica, Dosa dhe Bletë, kontrollin në kategori fillimisht do nisim me kontrollin e Lopëve dhe normalisht tek të gjithë fermerët që kanë aplikuar përveq Lopëve edhe për nënkategori tjera kontrolli do të realizohet njëkohësisht. I gjithë procesi i kontrollit për krerë do të zgjasë nga 1 korriku – 31 tetor.

Në procesin e kontrollit për aplikuesit për kafshë dhe bletë do të angazhohet 11-18 ekipe dhe besojmë se do të realizohet sipas Planit, 1 korriku – 31 tetor.



Kontrolli në terren për Pagesa Direkte / Vreshtave

Kontrolli i vreshtave - është më i lehtë sepse kemi numër të vogël të aplikantëve për kontroll, kryesisht ata raste që nga Instituti i Vreshtarisë dhe Verëtarisë ka dyshime që i kanë shkukur (nxjerrur) trungjeve për shkak të vjetërsisë së vreshtave.

Kontrolli është planifikuar të kryhet nga 1-16 tetor.

Kontrolli në terren për Pagesa Direkte/ Perime në fushë të hapur

Kontrolli i perimeve - bazuar në Programin e Pagesave Direkte 2015 për mbështetje në listë janë 22 kultura perimore. Te kontrolli i perimeve problemi është tek kontrolli i lakrës, pasi që edhe mbjellja është e vonshme.

Ky proces në tërësi është planifikuar të kryhet nga 1 korriku deri me 17 gusht.

Kontrolli në terren për Pagesa Direkte / Qumësht sipas cilësisë

Kontrolli i qumështit - kontrolli i qumështit nuk do të kryhet nga AZHB, përkatësisht nga inspektorati i Divizionit të Kontrollit.

Kontrolli në terren për Pagesa Direkte / Materialit fidanor dhe therrja e kafshëve

